



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 11 prill 2017
Nr. ref.:VVMP 1054/17

VENDIM PËR VAZHDIMIN E MASAVE TË PËRKOHSHME

në

rastin nr. KO12/17

Parashtrues

Avokati i Popullit

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së
neneve 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66,
67, dhe 68 të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga Institucioni i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston kushtetutshmërinë e dispozitave të caktuara të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje (Ligji i kontestuar), i cili hyri në fuqi në janar të vitit 2017, përkatësisht nenet 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, dhe 68.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së dispozitave të Ligjit të kontestuar të referuara më lart, për të cilat parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk janë në pajtueshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
4. Parashtruesi i kërkesës më tej kërkon nga Gjykata që të vendosë masa të përkohshme, duke suspenduar zbatimin e neneve 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, dhe 68 të Ligjit të kontestuar deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 2, nën-paragrafin 1, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës dhe në nenet 22, 27, 29 dhe 30 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullat 54, 55, 56, 62, dhe 64 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë pas miratimit të masave të përkohshme

6. Më 15 shkurt 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës miratimin e masave të përkohshme në rastin nr. KO12/17. Të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri vendosi të miratojë masat e përkohshme deri më 30 prill 2017.
7. Më 16 shkurt 2017, Sekretariati i Kuvendit dorëzoi në Gjykatë dokumente relevante për rastin, duke përfshirë Memorandumin shpjegues të Ligjit të kontestuar; Certifikatën e përputhshmërisë me “*Acquis të BE-së*” të nxjerrë nga Ministria e Integrimit Evropian; Certifikatën mbi Vlerësimin e Ndikimit Buxhetor të lëshuar nga Ministria e Financave; dhe Certifikatën e Pajtueshmërisë me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
8. Më 28 shkurt 2017, Komisioni i Kuvendit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejme: Komisioni për Legjislacion) dorëzoi komentet e veta lidhur me kërkesën.

9. Më 3 mars 2017, Gjykata e njoftoi Presidentin e Republikës, Kryeministrin, Avokatin e Popullit, Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrinë e Drejtësisë në lidhje me komentet e pranuar nga Komisioni për Legjislacion dhe dokumentet e pranuar nga Sekretariati i Kuvendit, si dhe u dorëzoi kopjet e të gjitha parashtrësive. Gjykata gjithashtu i njoftoi se ata mund të paraqesin komentet e tyre shtesë, nëse kanë, deri më 13 mars 2017.
10. Më 13 mars 2017, Avokati i Popullit dorëzoi përgjigjen lidhur me komentet e dorëzuara nga Komisioni për Legjislacion, si dhe lidhur me dokumentet e pranuar nga Sekretariati i Kuvendit.
11. Më 14 mars 2017, Gjykata e njoftoi Presidentin e Republikës, Kryeministrin, Kryetarin e Kuvendit, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ministrinë e Drejtësisë dhe Sekretariatit e Kuvendit në lidhje me përgjigjen e pranuar nga Avokati i Popullit dhe u dorëzoi nga një kopje duke u dhënë mundësinë të ofrojnë komente shtesë, nëse kanë, deri më 21 mars 2017. Gjykata nuk pranoi asnjë koment.
12. Më 5 prill 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese që i rekomandonte Gjykatës vazhdimin e masave të përkohshme, të miratuara më 15 shkurt 2017. Të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri vendosi të vazhdojë masat e përkohshme deri më 15 qershor 2017.

Përkritazi me vazhdimin e masave së përkohshme

13. Gjykata i referohet Vendimit të saj për masat e përkohshme të 15 shkurtit 2017 në këtë rast.
14. Gjykata vëren se palë të interesuara për pranueshmërinë dhe meritat e kësaj kërkesë kanë dorëzuar vëllim të konsiderueshëm të dokumenteve dhe të komenteve. Gjykata konsideron se duhet t'i kushtohet vëmendje të gjitha argumenteve të paraqitura.
15. Rrjedhimisht, pa paragjykim të çfarëdo vendimi të mëtejshëm që do të nxirret nga Gjykata në të ardhmen përkritazi me pranueshmërinë ose me meritat e kësaj kërkesë, Gjykata vendos të vazhdojë masat e përkohshme deri më 15 qershor 2017.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në pajtim me nenin 116 (2) të Kushtetutës, me nenin 27 të Ligjit dhe me rregullat 54 dhe 55 të Rregullores së punës, më 5 prill 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA VAZHDOJË masat e përkohshme deri më 15 qershor 2017;
- II. TA VAZHDOJË PEZULLIMIN e zbatimit të neneve 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67 dhe 68 të Ligjit për Kundërvajtje, gjatë kohëzgjatjes së njëjtë;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. TË SHPALLË që ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Gresa Caka-Nimani

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi

